



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:237293

Datë: 21.12.2023

Numri i dokumentit: 05106867

C-IV-13-2513

Ankuesja

I P, Prizren.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 21 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- APROVOHET** ankesa si pjesërisht e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRZ041-0111 datë 25 shtator 2013.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankueses **I P** në emër të kërkesës për kompensim për pagat e pa paguara për periudhën prej 01 dhjetor 2007 deri më 31 gusht 2010 (33 paga x 138.00 €), t’i paguaj **shumën prej 4,554.00 €**, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, refuzohet si e pabazuar.
- Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 22 tetor 2013, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRZ041-0111 të datës 25 shtator 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme nga AL kërkesa e saj për kompensim për 50 paga të papaguara në shumë prej 6,900.00 (50 x 138.00 €) nga NSH “Liria” në Prizren (në likuidim). Ankuesi pohon se me vendimin e AKP-së i është refuzuar kërkesa e tij lidhur me kompensimin e pagave të papaguara dhe se sipas aktvendimit në fjalë ka mangësi shkaku i të cilëve nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij dhe se dispozitivi i aktvendimit në pjesën refuzuese është në kundërshtim me arsyet në të cilat është bazuar aktvendimi. Vërtetimi i së drejtës së kërkesës për kompensim në bazë të së drejtës nga puna, ka të bëjë me të drejtën e rregulluar me ligj dhe me kontratën kolektive të cilat udhëzojnë kundërshtuesin që të administroj prova të duhura në këtë drejtim,

përndryshe dokumentet financiare dhe juridike të NSH-së përkatëse gjinden pranë AKP-së. Prandaj, provat lidhur me ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës nuk mund të kërkohet pala e cila posedon një dëshmi të tillë. Ankuesi më tej pohoi se vendimi i mohuar i të paditurës konstaton se kërkesa e tij për kompensim është brenda afatit gjë e cila jep të kuptohet se bazueshmëria e së njëjtës është dashur të shqyrtohet dhe se në arsyetimin lidhur me refuzimin e kërkesës si të pavlefshme thuhet se kërkesa është e parashkruar, një gjë e tillë nuk mund të pranohet, ngase është në kundërshtim me vetveten. Prandaj, periudha e parashkrimit nuk mund të bazohet në ligjin e cituar, duke marrë parasysh datën e hyrjes së këtij ligji në fuqi. Sipas LPB, punëtori nuk mund të inicioj procedurën pranë gjykatës kompetente lidhur me mbrojtjen e ndonjë të drejte nga marrëdhënia e punës, para përfundimit të procedurës interne në mes të punëtorit dhe punëdhënësit. Ankuesja më tej pohoi se gjykata e rregullt nuk është kompetente të vlerësoj ligjshmërinë e ligjit, ajo e vlerëson ligjshmërinë e punëve juridike të ndërmarrë nga kundërshtuesi, duke u bazuar në rregullat e Ligjit për AKP-në. Ankuesja, kundër vendimit të së paditurës inicicion procedurën brenda afatit ligjor pranë gjykatës dhe se duke u bazuar nga fjalitë e cituara nga vendimi i kundërshtuar se kërkesa është brenda afatit, ankuesi inicicion procedurën e rishikimit të vendimit refuzues në gjykatë. Ankuesja i propozon gjykatës që të revidoj aktvendimin e të paditurës duke e aprovuar kërkesën e saj. Ankuesja në mbështetje të ankesës së saj ka bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 13 qershor 2014, e paditura parashtroi mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura thekson se ankuesi nuk ka respektuar Nenin 24.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parasheh që *“Secili parashtrues dhe palë kundërshtare përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës apo odës së avokatëve”*. Prandaj, ankuesja nuk ka caktuar një përfaqësues ligjor dhe ka shkelur kështu nenin e lartpërmendur. Asnjë autorizim nuk është përfshirë në shkresat e lëndës. Ankuesja thjesht nuk pajtohet me vendimin e AL-së por pa ofruar ndonjë argument ligjor kundër tij dhe se duke mos dhënë asnjë argument ligjor, ankuesi nuk ka respektuar Nenin 27.2.4 i cili kërkon nga ai të ofroj të gjitha faktet materiale dhe argumentet ligjore mbi të cilat bazohet ankesa. E paditura më tej theksoi se i përmbahet qëndrimit se ankesa është e papranueshme. Nëse gjykata konstaton se ankesa është e pranueshme, e paditura pohon se ankesa është gjithashtu e pabazuar për arsyet e cekura më poshtë. Ankuesja nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034, mbi të cilin është bazuar vendimi i AL-së parasheh që: *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të kapitalit apo pronësisë...Kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Neni 608 i LPB (publikuar në GZ Nr.53/1976), i zbatueshëm sipas Kreut 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 parasheh që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të një punëtori që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”*. Kërkesa ka të bëjë me 50 paga që kanë mbetur të papaguara që nga korriku 2006 në bazë të dokumentacionit e gjetur në arkivin e NSH-së nga AL. Duke marrë parasysh se afati i parashkrimit është 3 vjet, kërkesa është parashkruar në korrik 2009 që është tre vjet pasi NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimet e saja nga kontrata e punës. E paditura më tej theksoi se argumenti i lartpërmendur është mbështetur nga vendimet e nxjerra nga Dhoma e Posaçme, respektivisht C-II-13-0190-C0001 dhe SCL-11-0046 datë 14 janar 2014. *“Baza kryesore ligjore për konstatim të kërkesës si e pabazuar është Neni 608 i LPB, i zbatueshëm sipas kreut 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 që parasheh 3 vjet afat të parashkrimit që fillon nga koha kur NSH nuk ka përmbushur detyrimet ndaj punonjësit...”*. E paditura i propozoj gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar si

dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur në kopje si: Vendimin për fillimin e likuidimit dhe emërimin e anëtarëve të parë të AL datë 11 qershor 2013.

Me 29 korrik 2014, ankuesja dorëzoi përgjigjen e saj në mbrojtjen e të paditurës.

Me 09 shtator 2014, e paditura dorëzoi kundërpërgjigjen e saj.

Me 27 shtator 2022, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesen përmes së cilit ndër të tjera kërkoi prova shtesë. Në përgjigjen e saj të datës 21 tetor 2022, ankuesja dorëzoi një parashtrësë në gjykatë përmes së cilës, veç tjerash e njoftoi gjykatën se nuk është kontestuese se marrëdhënia e saj e punës është ndërprerë me 30 nëntor 2010. Në mbështetje të parashtrësës së saj dorëzoi dëshmitë në kopje si: Vendimin nr.74 datë 10 mars 1999 lëshuar nga “Liria” SH.A. e Pronësisë së Përzier, Librezën e saj të punës nr. 200667 nr. i regjistrimit 19595, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit drejtuar ankueses lëshuar nga AKP datë 30 nëntor 2010, Njoftimin e AL për Fillimin e Likuidimit të Ndërmarrjes nr. 1354 datë 25 qershor 2013, Vendimet nr. PRZ041-0178 dhe PRZ041-0141, që të dyja të datës 25 shtator 2013, me të cilat ishin aprovuar nga AL kërkesat e saj për kompensim për tre paga të papaguara (1 shtator – 30 nëntor 2010) dhe kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, Kartelën e llogarisë bankare, Historiatin e llogarisë bankare lëshuar nga Banka Ekonomike nga data 01 janar 2006 - 17 tetor 2022, Letërnjoftimin e saj dhe Vërtetimin datë 04 shtator 2012, lëshuar nga NSH.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*”. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*” .

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesja ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRZ041-0111, datë 25 shtator 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme (e parashkruar) nga AL kërkesa e saj për kompensim për 50 paga të papaguara në shumë prej 6,900.00 (50 x 138.00 €) për periudhën korrik 2006 – nëntor 2010 nga NSH “Liria” në Prizren (*në likuidim*).

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja ishte një punëtore e NSH “Liria” në Prizren. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesja dhe a i ka mbetur NSH borgj pagat për periudhën korrik 2006 – 30 nëntor 2010. E paditura e kundërshton kërkesën e ankueses duke pretenduar se kërkesa e saj për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar, ndërsa ankuesja pretendon se kërkesa e saj është e ligjshme dhe e njëjta nuk është e parashkruar. Ankuesja, bazën e kërkesës së saj ndër të tjera e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit drejtuar asaj lëshuar nga AKP datë 30 nëntor 2010, Librezën e saj të punës nr. 200667 nr. i regjistrit 19595, Njoftimin e AL për Fillimin e Likuidimit të Ndërmarrjes nr. 1354 datë 25 qershor 2013, Vendimet nr. PRZ041-0178 dhe PRZ041-0141, që të dyja të datës 25 shtator 2013, me të cilat ishin aprovuar nga AL kërkesat e saj për kompensim për tre paga të papaguara (1 shtator – 30 nëntor 2010) dhe kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, Vërtetimin datë 04 shtator 2012, lëshuar nga NSH për pagat e papaguara për periudhën objekt kontesti, si dhe në pohimet e saj të parashtruara në ankesë.

Nga, njoftimi për përfundimin e punësimit, i datës 30 nëntor 2010 dhe librezja e saj e punës të dorëzuara si prova, vërtetohet fakti se ankuesja ishte në marrëdhënie pune në NSH “Liria” deri me 30 nëntor 2010, kohë edhe kur shumica (apo të gjitha) asetet e NSH-së janë shitur dhe si pasojë marrëdhënia e punës së saj ka pushuar.

Nga pohimet e saj të parashtruara në ankesë dhe Vërtetimi datë 04 shtator 2012, lëshuar nga NSH (të cilat nuk kontestohen nga e paditura) vërtetohet fakti se ankuesja kishte punuar dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankueses si dhe punëtorëve të tjerë të ndërmarrjes pagat prej datës 30 qershor 2006 e deri në momentin e privatizimit përkatësisht 30 nëntor 2010.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, Njoftimin për përfundimin e punësimit, lëshuar me 30 nëntor 2010 nga AKP, Librezën e saj të punës, Vërtetimin datë 04 shtator 2012, Vendimet nr. PRZ041-0178 dhe PRZ041-0141, që të dyja të datës 25 shtator 2013, për të arritur në përfundim se ankuesja ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesja

nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borxh pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesja. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesja, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankueses, gjykata e aprovon pjesërisht kërkesën e saj.

Me rastin e aprovimit të shumës totale në lartësi prej 4,554.00 €, gjykata i njeh ankueses 33 paga mujore të papaguara nga gjithsejtë 50 paga mujore të kërkuara për periudhën objekt kontesti. Gjukata ia njeh ankueses pagat mujore të papaguara nga muaji dhjetor 2007 e deri në 31 gusht 2010 (pasi që 3 pagat e fundit të papaguara shtator, tetor dhe nëntor 2010, AL veç ia ka njohur ankueses me vendimin nr. PRZ041-0178), meqë këto nuk janë të parashkuara, ndërsa pagat e papaguara nga korriku 2006 deri në nëntor 2007, veç janë parashkruar dhe si të tilla refuzohen.

Gjukata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankueses është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesja kishte dorëzuar kërkesën e saj brenda afateve tek AL me 16 korrik 2013. Gjukata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 30 nëntor 2010 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar në tërësi nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Andaj, gjykata vie në përfundim se ankuesja kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borgj pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar